

VENDIM
Nr.529, datë 11.12.1992

**PËR KRITERET DHE KOMPETENCAT E ORGANEVE SHETETËRORE E PRIVATE NË
FUSHËN E STANDARDIZIMIT DHE TË CILËSISË**

Në zbatim të ligjit të Kuvendit Popullor nr.7630, datë 28.10.1992 "Për standardizimin dhe cilësinë", Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
KRITERET DHE KOMPETENCAT PËR STANDARDIZIMIN

Neni 1

Në kriteret e standardizimit përfshihen:

- a) Vendosja e treguesve cilësorë të njësuar e të përparuar për lëndët e para e materialet, produktet e gatshme, ndërtimet e shërbimet, mbrojtjen e mjedisit, sigurimin në punë, si dhe e metodikës së njësuar për vlerësimin e cilësisë së prodhimeve, të ndërtimeve e të shërbimeve.
- b) Mbrojtja e të drejtave të konsumatorit.
- c) Nxitja e rritjes së cilësisë së prodhimeve dhe llojshmërisë së tyre, si dha garantimit cilësisë deri te përdoruesi.
- ç) Përcaktimi i kushteve të ambalazhimit e të etiketimit dhe të ruajtjes e të transportimit të prodhimeve.
- d) Nxitja e thjeshtimit, njësimit e tipizimit në prodhim, ndërtim e shërbim.
- e) Lehtësimi i shkëmbimeve të mallrave, duke mënjeluar pengesat teknike.

Neni 2

Projektstandartet i dërgohen për miratim Drejtorisë së Standardizimit dhe të Cilësisë, pasi të jetë marrë nga propozuesi mendimi i ministrisë oses institucionit tjeetër qendror prodhues e përdorues. Për produktet ushqimore dhe të tjera që lidhen me anën shëndetësore, merret mendimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, për ambalazhet merret mendimi i Ministrisë së Transporteve dhe të Komunikacioneve, për pajisjet elektrike, nën trysni e të sigurimit teknik, merret mendimi i inspektorateve përkatëse dhe për aparatet matëse ai i organizimit që merret me kontrollin e mjeteve matëse.

Neni 3

Parastandardet e detyrueshme miratohen nga ministria prodhuese, në bashkëpunim me ministrinë përdoruese, pasi merret për artikujt ushqimorë mendimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, për ambalazhet mendimi i Ministrisë së Transporteve dhe Komunikacioneve dhe për pajisjet nën trysni, elektrike, të sigurimit teknik etj. mendimi i inspektorateve përkatëse.

Parastandardet e tjera, kampionët, modelet, vizatimet e punës dhe recepturat miratohene nga prodhuesi, në bashkëpunim me përdoruesin.

Për artikujt elektroshtëpiakë, pajisjet nën trysni, prodhimet ushqimore e kimike, që cënojnë shëndetin dhe sigurinë e jetës, parastandardet, kampionët, modelet, vizatimet e punës dhe recepturat miratohen nga dega e standardizimit dhe e cilësisë në rreth, pasi të jetë marrë nga propozuesi edhe mendimi i organeve përkatëse të specializuara.

Neni 4

Të drejtën e shumëfishimit të standardeve e ka Drejtoria e Standardizimit dhe e Cilësisë. Në raste të veçanta ajo autorizon edhe organe të tjera për shumëfishimin e tyre.

Të drejtën e shitjes së standardeve e ka kjo drejtori me degët e saj në rrethe.
Parastandardet shumëfishohen dhe shiten nga organi i emërtesës.

Neni 5

Lëndët e para, materialet dhe produktet e gatshme shoqërohen me certifikatë cilësie dhe me etiketë mbi ambalazh.

Makineritë, pajisjet teknologjike dhe ato elektroshtëpiake shoqërohen me pasaportën teknike, instruksionin e përdorimit, certifikatën e cilësisë dhe fletëgarancinë.

Elementet e ndërtimit shoqërohen me vertefikatën e cilësisë.

Riparim-shërbimet shoqërohen me fletëgarancinë.

Në etiketat e produkteve ushqimore, farmaceutike, imunobiologjike, veterinare, higjieniko-shëndetësore dhe të prodhimeve kimike vendoset edhe afati maksimal i përdorimit.

KREU II DREJTIMI, KONTROLLI DHE SIGURIMI I CILËSISË

Neni 6

Ndërmarrjet prodhuese e përdoruese dhe personat e tjerë juridikë e fizikë merren me drejtimin e cilësisë, i cili përcakton synimet e programuara për rritjen e vazhdueshme të saj, duke u mbështetur në mundësitë njerëzore, materiale e teknike.

Në subjektet e mësipërme organizohet kontrolli i cilësisë, i cili përfshin: matjet, provat, analizat dhe verifikimin e një a disa kërkesave të produktit ose të shërbimit dhe ekrahasimin e rezultateve të tyre me kërkesat e standardeve, parastandarëve, kushteve teknike, kampioneve, modeleve, kushteve të projektivit dhe zbatimit dhe recepturave, për të përcaktuar përputhjen ose jo të tyre, me synim vlerësimin e cilësisë.

Neni 7

Mallrat e eksportit u përgjigjen standardeve shqiptare, ndërkombëtare ose specifikimeve e kampioneve të miratuar nga porositësit me marrëveshje të përbashkët. Ato shoqërohen me dokumente, ku shënohen treguesit faktikë cilësirë sipas standardeve shqiptare, ndërkombëtare, specifikimeve ose kampioneve të miratuar me marrëveshje të përbashkëta.

Mallrat e importit të jenë sipas standardeve ndërkombëtare, specifikimeve të porositësit, ose kampionit të pranuar me marrëveshje të përbashkët, por jo nën nivelin e kërkesave cilësore të detyrueshme të standardeve shqiptare. Në të kundërt bëhet vlerësimi cilësor i tyre.

Mallrat e eksportit, të importit dhe ato që prodhohen për vend, të shoqërohen deri te përdoruesi me certifikatë cilësie. Në çdo njësi ambalazhi vendoset etiketa sipas standardit përkattës, data e prodhimit dhe, sipas natyrës së mallit, edhe afati maksimal i përdorimit. Certifikata e cilësisë lëshohet nga prodhuesi, laboratorët e akredituar nga Drejtoria e Standardizimit dhe e Cilësisë dhe laboratorët e degëve të standardizimit në rrethe. Mostra merret pa pagesë nga punonjësit e standardizimit dhe të cilësisë.

Organet doganore kryejnë zhdoganimin ose doganimin e mallrave të importit e të eksportit, vetëm kur ato janë të shoqëruara me certifikatë cilësie.

Neni 8

Organet, institucionet dhe laboratorët që merren me vlerësimin e cilësisë së mallrave të vendit, të eksportit e të importit, akreditohen dhe certifikohen nga Drejtoria e Standardizimeve dhe Cilësisë.

Personat juridikë e fizikë paguajnë për shërbimet që u kryhen, tarifat përkatëse, të caktuara nga Drejtoria e Standardizimeve dhe e Cilësisë.

Neni 9

Ndërmarrjet prodhuese e përdoruese dhe personat e tjerë juridikë e fizikë merren me sigurimin e cilësisë, si element i drejtimit të tyre. Sigurimi i cilësisë është tërësia e masave që merren për të krijuar besimin te përdoruesi për cilësinë e prodhimit, të ndërtimit e të shërbimit.

Neni 10

Ndërmarrjet dhe personat e tjerë juridikë e fizikë, që prodhojnë mallra me standarde të detyrueshme, ose prodhojnë mallra a kryejnë shërbime që lidhen me shëndetin, sigurinë e jetës dhe çënojnë të drejtën e konsumatorit, kanë këto detyra e të drejta kryesore:

a) Të kontrollojnë cilësinë e lëndëve të para e të materialeve të tjera dhe të ndalojnë marrjen në dorëzim e përdorim të tyre, kur nuk u përgjigjen standardeve, parastandarëve, kampionëve, modeleve, kushteve të projektimit e të zbatimit, vizatimeve të punës, recepturave dhe kërkesave të marrëveshjeve për cilësinë.

b) Të kontrollojnë procesin e prodhimit, të ndërtimit e të shërbimit dhe ta ndalojnë atë në çdo fazë, kur nuk garantohej cilësia përfundimtare e prodhimit, ndërtimit e shërbimit.

c) Të kontrollojnë produktet e gatshme e gjysmë të gatshme që hyjnë në magazinë, dhe të ndalojnë shpërndarjen e tyre, kur ato nuk janë në përputhje me kërkesat e standardeve, parastandarëve, kampionëve, modeleve, kushteve të projektimit e të zbatimit, vizatimeve të punës dhe recepturave.

Neni 11

Për të rritur pavarësinë për vetëveprim për standardet dhe kontrollin e cilësisë dhe për të mbrojtur të drejtat e konsumatorit në ekonominë e tregut të lirë, në rrethe krijohen degët e standardizimit dhe të cilësisë në varësi të Drejtorisë së Standardizimit dhe Cilësisë.

Në përbërje të degës është edhe laborator i cilësisë në rreth.

Dega e standardizimit dhe e cilësisë, brenda juridiksionit ku vepron ka këto të drejta dhe detyra kryesore:

a) Kontrollon zbatimin e standardeve, parastandardëve, kampionëve, modeleve, kushteve të projektimit e zbatimit, vizatimeve të punës, recepturave, si dhe kërkesave të marrëveshjeve për cilësinë e prodhimeve, ndërtimeve e shërbimeve në ndërmarrje dhe në personat juridikë e fizikë.

b) Miraton modele, receptura dhe kampione sipas emërtesës.

c) Merr pjesë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe në ekspertizë për problemet e cilësisë.

d) Autorizon laboratorët e rrethit për kryerjen e analizave laboratorike.

dh) Thërret përfaqësues të ndërmarrjeve, institucioneve shkencore, organizatave, shoqatave e personave të tjerë juridikë e fizikë dhe kërkon nga këta të dhëna për problemet e cilësisë.

Neni 12

Organet e standardizimit dhe të kontrollit të cilësisë në ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, brenda fushës së veprimtarisë së tyre në ndërmarrje dhe në personat e tjerë juridikë e fizikë, kanë këto të drejta dhe detyra kryesore:

a) Ndjekin, ndihmojnë e kontrollojnë zbatimin drejt të akteve ligjore e nënligjore për standardizimin dhe cilësinë.

b) Sigurojnë udhëheqjen metodike, drejtojnë, organizojnë dhe kryejnë vetë ose në bashkëpunim me institutet dhe ndërmarrjet, studime, analiza tërësore a të veçanta, për të nxitur rritjen e cilësisë.

c) Miratojnë parastandardet.

ç) Kontrollojnë zbatimin e standardeve, parastandarëve, kushteve të projektimit e të zbatimit, kampionëve, modeleve, vizatimeve të punës, recepturave, si dhe të kërkesave të marrëveshjeve për cilësinë në prodhim, ndërtim e shërbim të sistemit të tyre.

d) Marrin pjesë në ekspertizat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që i përkasin veprimtarisë së tyre.

Neni 13

Punonjësit e Drejtorisë së Standardizimit dhe të Cilësisë, të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore dhe të degëve të standardizimit dhe cilësisë në rrethe, kur e shohin të nevojshme, bashkëpunojnë gjatë kontrolleve me inspektoratin higjieniko-shëndetësor, inspektoratet e tjera përkatëse, policinë financiare dhe forcat e ruajtjes së rendit.

Neni 14

Numri i punonjësve në organikën e Drejtorisë së Standardizimit dhe Cilësisë është 140 veta, prej të cilëve 70 veta merren nga organika e këshillave të rretheve, 8 veta nga organika e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave dhe 62 veta shtesë në organikë.

Organikave të këshillave të rretheve Bulqizë, Delvinë, Devoll, Has, Kolonjë, Kuçovë, Laç, Malësi e Madhe, Mallakastër e Peqin u zbritet nga numri 1 veetë, kurse organikave të rretheve të tjera u zbriten 2 veta dhe rrethit të Tiranës 8 veta.

Për efekt pagese punonjësit e Drejtorisë së Standardizimit dhe Cilësisë trajtohen si drejtori i përgjithshme, kurse degët në rrethe si seksionet e këshillave të rretheve.

Emërtimet e punonjësve të degëve të standardizimit dhe të cilësisë bëhen nga Drejtoria e Standardizimit dhe e Cilësisë.

Drejtorisë së Standardizimit dhe Cilësisë i kalon në inventar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave një autoveturë.

Neni 15

Drejtorja e Standardizimit dhe e Cilësisë është organizëm shtetëror buxhetor. Të ardhurat që vijnë nga shitja e standardeve, certifikimi i mallrave, dhënia e markës së cilësisë, akreditimi i laboratorëve, tarifat për analizat kimike, ekspertiat për standardet dhe cilësinë, si dhe gjobat, të cilat realizohen nga punonjësit e standardeve e të cilësisë, derdhen në buxhet.

Neni 16

Shtypja e standardeve bëhet nga Drejtoria e Standardizimit dhe e Cilësisë.

Neni 17

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.98, datë 16.3.1992 "Për kriteret dhe kompetencat në fushën e standardizimit dhe të cilësisë", dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie ndesh me këtë vendim, shfuqizohet.

Neni 18

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi